

BULETINI 3 - MUJOR

Tetor- Dhjetor
2025

Skema Kombëtare
2025: 2 MLD lekë
shtesë për fermerët

Mbahet Komiteti i
III- të i Monitorimit
për IPARD III

LPIS, verifikim
në terren i parcelave
të digjitalizuara

TAKIM ME PËRFAQËSUES TË SEKTORIT BUJQËSOR NË TË GJITHË VENDIN

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, gjatë takimit “Me fermerët, për fermerët”, në prani të Kryeministrit Edi Rama dhe prodhuesve nga i gjithë vendi, prezantoi Buxhetin 2026, i cili arrin vlerën 16.3 miliardë lekë.

Ky buxhet parashikon më shumë mbështetje direkte, investime, financim të lehtësuar dhe masa të shtuara për sigurinë ushqimore, duke forcuar sektorët prioritarë si bujqësia, blegtoria, peshkimi, agro-përpunimi dhe agroturizmi, si edhe pensionin rural.

Po ashtu, u theksua rëndësia e trajnimit dhe rritjes së kapaciteteve profesionale të fermerëve, përmes bashkëpunimit me Universitetin Bujqësor të Tiranës, me synimin që dija, teknologjia dhe përvoja të shkojnë drejtpërdrejt në terren, aty ku çdo ditë prodhohet me cilësi për tregje elitare ndërkombëtare.

Në këtë kuadër, mbështetja për Skemën Kombëtare rritet me 16%, krahasuar me buxhetin e fillimit të vitit 2025.



TAKIMI I III-TË I KOMITETIT TË MONITORIMIT PËR PROGRAMIN IPARD III

Zhvillohet Takimi i III-të i Komitetit të Monitorimit për Programin IPARD III (2021–2027). Takimi mbledhi përfaqësues të sektorit bujqësor, partnerë ekonomikë e socialë, institucionet e linjës, Komisionin Evropian dhe donatorë ndërkombëtarë. Drejtoresha e Përgjithshme e AZHBR, Znj. Arditë Kuçi, së bashku me strukturat e IPARD-it dhe MBZHR-së, prezantuan përgatitjet për masat e reja të mbështetjes në kuadër të Programit IPARD III, i cili synon zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe zonave rurale.

Ky takim erdhi pak ditë pas hapjes së kapitullit të fundit të negociatave me BE-në, duke reflektuar progresin e Shqipërisë në bujqësi dhe hapat konkretë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Programi IPARD synon të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe zonave rurale në vend, duke kontribuar në përmirësimin e standardeve të jetesës, nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe rritjen e konkurrueshmërisë për tregun e përbashkët të Bashkimit Evropian

BERAT, VERIFIKIM NË TERREN I PARCELAVE TË DIGJITALIZUARA



Në kuadër të projektit pilot LPIS, me mbështetjen e ekspertëve të Qendrës së Përbashkët Kërkimore të Komisionit Evropian u krye verifikimi në terren i parcelave të digjitalizuara. Ekipi krahasoi kufijtë digjitalë me ata realë, vlerësoi përdorimin e tokës bujqësore dhe përdori pajisje GPS për matje të sakta, të shoqëruara me foto të gjeotaguara.

LPIS (Land Parcel Identification System) është një sistem digjital që siguron menaxhim të saktë dhe transparent të fondeve bujqësore. Ky proces përbën një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi modern, në përputhje me standardet e BE-së.

WORKSHOP 2-DITOR, NË KUADËR TË PROGRAMIT IPARD III



Strukturat e IPARD në Shqipëri morën pjesë në Workshop-in vjetor 2-ditor të organizuar nga DG AGRI, në kuadër të Programit IPARD III. Gjatë takimit u diskutuan tema të rëndësishme si: Thjeshtimi i procedurave administrative të aplikimeve, Përmirësimi i kontrolleve në terren, Mbështetja e fermerëve të rinj dhe zonave me më pak avantazhe, Përafrim i mëtejshëm me Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP) në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ky është një tjetër hap për forcimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimit ndërmjet vendeve përfituese të programit IPARD.

AZHBR MERR PJESË NË KONFERENCËN E 63-TË TË PANTA RHEI NË HOLANDË

Drejtoresha e Përgjithshme e AZHBR-së, znj. Ardita Kuçi, mori pjesë në Konferencën e 58-të të Drejtorëve të Agjencive të Pagesave të BE-së, e zhvilluar në Kopenhagen, Danimarkë, më 19-21 nëntor 2025.

Konferenca u fokusua në përdorimin e inteligjencës artificiale në administrimin e skemave të mbështetjes, thjeshtimin administrativ dhe erritjen e efikasitetit institucional, modernizimin e proceseve dhe tranzicionin e gjelbër në bujqësi.

Në kuadër të saj, u nënshkrua edhe marrëveshja e bashkëpunimit mes AZHBR-së dhe Agjencisë Polake ARMA, për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përgatitjen për zbatimin e fondeve dhe politikave të BE-së në bujqësi.

Pjesëmarrja në këtë konferencë forcon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave me agjencitë homologe evropiane dhe kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që AZHBR ofron për fermerët në mbarë vendin.



+2 MLD LEKË

mbështetje për fermerët

buxheti 2025

filloi me
4.4 mld lekë



2 MLD LEKË SHITESË MBËSHTETJE PËR FERMERËT

Me aktin normativ të fundvitit, mbështetja për fermerët përmes Skemës Kombëtare 2025 arrin në 6.4 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 20.8% krahasuar me vitin e kaluar. Kjo mbështetje synon uljen e kostove të prodhimit dhe garantimin e vijimësisë së prodhimeve vendase, në shërbim të drejtpërdrejtë të fermerëve. Skema Kombëtare 2025 ofron mbështetje për tufën bazë të matrikulluar, bletarinë, fara-fidanë dhe inpute të tjera, bimët mjekësore dhe aromatike, fermat organike, certifikimi Global Gap dhe mbështetje me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi.

TAKIME NË TERREN PËR KREDINË E BUTË ME GARANCI SOVRANE

Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural zhvilloi një seri takimesh informuese me fermerë dhe agrobiznese në 12 qarqe të vendit, në kuadër të hapjes së aplikimeve për Kreditë e Butë me Garanci Sovrane.

Takimet u realizuan në bashkëpunim me përfaqësues të bankave të nivelit të dytë, gjatë të cilave pjesëmarrësit u informuan në detaje mbi procedurat e aplikimit, kriteret dhe hapat konkretë për të përfituar nga kjo skemë financimi. Kredia e Butë me Garanci Sovrane ofroi mundësi financimi për investime në bujqësi dhe blegtori, agropërpunim, mekanizimin e bujqësisë, turizëm rural dhe akuakulturë detare, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit bujqësor në të gjithë vendin.

- Normë interesi vetëm 2%;
- Mbulim kolaterali 70%;
- Financim deri në 25 milionë lekë për subjekt.

Aplikimet u kryen pranë bankave të nivelit të dytë.

